



Ne baze të nenit 11 dhe 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17, të Ligjit Nr.10/L-022 për banim social dhe të përballeshëm, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2026”, e konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2010 për përmbajtjen e bonus banimit dhe nenit 15, lidhur me nenin 29, paragrafi 2 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

## **Projekt-V E N D I M**

### **Neni 1**

Me këtë vendim përcaktohet vlera financiare e subvencionimit të qirasë në njësinë e banimit privat dhe atë **50%** e shumës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesi për vitin 2026.

### **Neni 2**

2.1 Përfitues të subvencionimit të qirasë në njësinë e banimit privat për vitin 2026, do të jenë 15, (pesëmbëdhjetë) familje apo individ, vlera financiare për subvencionimin e qirasë vjetore për të gjitha familjet apo individ përfituese në total është 25,000.00€ të planifikuara nga buxheti i Komunës së Suharekës.

2.2 Kategorit e familjeve apo individ që mund të përfitojnë janë; 1. Familja apo individ me gjendje jo të mirë ekonomike apo përfitues të asistencës sociale, 2. Familjet e mëdha me shumë fëmijë dhe familjet me një prind dhe 3. Viktimat e dhunës në familje.

### **Neni 3**

Për zbatimin këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqene sociale në bashkëpunim me Drejtorinë për urbanizëm dhe planifikim në Komunën e Suharekës.

### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

## **K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë**

01-Nr- \_\_\_\_\_  
Më datë \_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**